

Informacion për Koronavirusin (Coronavirus)

Në javët e fundit mjaft është raportuar në media për Koronavirusin. Koronavirusi në të shumtën e rasteve është më pak i rrezikshëm se një grip. Megjithatë, është me rëndësi që përhapja e tij mundësisht të pengohet.

Raste të dyshimta (shiko kutitë më poshtë) do të kontrollohen me një test laboratorik dhe do të izoloohen në Spitalin shtetëror. Nëse konstatohen një infeksion me Koronavirus, atëherë personat të cilët në ditët e fundit kanë pasur kontakte me personin e sëmurë, do të qëndrojnë në shtëpi. Ata nuk duhet të kenë kontakt me persona të tjerë. Nëse të këta persona shfaqen simptoma, këta persona gjithashtu do të testohen. Testet të personat pa simptome nuk kanë kuptim.

Për rastet e dyshimta duhet të kontaktohet me **telefon** Spitali shtetëror. Ata nuk duhet të shkojnë në ndonjë ambulancë mjekësore. Spitali shtetëror e sqaron, merr prova, ndërmerr teste laboratorike dhe i izolon personat.

Një person është „rast i dyshimtë“ nën këto kushte:

Ai/ajo në 14 ditët e fundit ka qëndruar në ndonjë territor i prekur ose ai/ajo në 14 ditët e fundit ka pasur kontakt me ndonjë person, të cili përmes një testi laboratorik është dëshmuar infeksion.

dhe

ai/ajo ka simptome të një sëmundjeje të rrugëve të frymëmarrjes (p.sh. kollitje, vështirësi në frymëmarrje).


Çfarë duhet bërë te një rast i dyshimtë?

Të qëndrojnë në shtëpi. Të mos dalë më në publik. Menjëherë të kontaktohet me telefon Spitali shtetëror. Thuani se keni qenë në një regjion i prekur nga virusi dhe se keni telashe.

Numri i telefonit i Spitalit shtetëror Landesspital: +423 235 45 32

Për pengimin e një përhapjeje të virusit vlejné të njëjtat masa higjienike sikur te një valë gripi:

- Lajini duart për çdo ditë më shumë herë dhe rrënjësisht me sapun ose me ndonjë mjet dezinfektues për duart.
- Nëse e keni patjetër të kollni ose të teshtitni, atëherë mbani para gojës dhe hundës një shami xhepi. Pastaj hudheni atë në ndonjë kovë për mbeturina, lajini duart mirë me ujë dhe sapun ose përdorni ndonjë mjet dezinfektues për duar.
- Nëse nuk keni një shami xhepi prej letre, atëherë kollitni ose teshtitni në bërrylin e krahut Tuaj.



Informacione të tjera i gjeni në Informationenfinden Sie auf den Webfaqet vijuese:

<http://bit.ly/corona-fl>

<http://bit.ly/corona-ch>

Shkurt 2020